



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prisijem / Predato Received / Delivery	29 - 12 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	7744 / 2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1419/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi- anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1419/2023 të datës 16.11.2023 të ankuesit në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1419/2023, e datës 16.11.2023, e parashtruara nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje referuar ankuesi), me datë 16.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjen A.nr.1419/2023, kundër Njoftimit të datës 26.10.2023 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me pretendimet ankimore se i njëjti e ka plotësuar dosjen e tij përmes kërkesës së datës 26.10.2023 duke e bashkangjitur Certifikatën e Gjykatës për çështje penale të datës 14.10.2023 pasi që për shkak të pengesave teknike nuk kishte arritur ta bënte me rastin e aplikimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Ranillgut, ndërsa, Këshilli

me datë 30.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6991/2023 të datës 16.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 16.11.2023 dërguar nga ankuesi për Këshillin; Ankesën e ankuesit të parashtruar në KKTK; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.11.2023; Konkursin e datës 18.09.2023; Vendimin e datës 16.11.2023 me shifër:29/2023; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit të datës 14.10.2023; Çertifikatën e datës 14.10.2023; Diplomë e datës 21.03.2011; Diplomë e datës 26.03.2012; Çertifikatë e datës 16.02.2011; Shkresë e datës 01.07.2011; Vërtetim të datës 27.03.2023; Çertifikatë e datës 06.01.2017; Vërtetimin e datës 05.03.2020; Letër rekomandimin e datës 06.03.2020; Letër rekomandim i datës 20.10.2007; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Njoftimin e datës 26.10.2023 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Njoftimin e datës 26.10.2023 për listën e ngushtë; Njoftimin e datës 30.10.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (tani e tutje KKTK), me datë 18.09.2023, ka shpallur konkursin e jashtëm-pranim, me numër të referencës RN00012568, emri i grupit "Specialistë Ligjor" pozita e punës "Zyrtar i Lartë Ligjor", Klasa " Profesional 1", numri i kërkuar një (1 vend pune), në kuadër të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, në të cilin konkurs vërtetohet fakti se ka aplikuar edhe ankuesi më datë 14.10.2023.

Tutje, Divizioni i Burimeve Njerëzore me datë 26.10.2023 e njofton ankuesin se të njëjtit i është refuzuar aplikacioni për shkak se nuk ka bashkangjitur në momentin e aplikimit dokumentin që dëshmon se ankuesi nuk ka masë të shqiptuar disiplinore në fuqi me këshillën juridike që i njëjti mund të parashtrojë ankesë të brendshme brenda tre (3) ditësh në Divizioni i Burimeve Njerëzore, kurse ankuesi në të njëjtën ditë me datë 26.10.2023 përmes e-mailit i drejtohet Divizionit të Burimeve Njerëzore me kërkesën për plotësimin e dosjes së tij të aplikimit duke e bashkangjitur Çertifikatën e datës 14.10.2023 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Divizioni i Burimeve Njerëzore të KKTK-së, pas kalimit të afatit tre (3) ditor të ankimimit të brendshëm me datë 30.10.2023 ka publikuar njoftimin për kandidatët që kanë hyrë listën e shkurt, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 30.10.2023 duke aluduar se aplikacioni i tij i datës 14.10.2023 është refuzuar për shkak të mungesës së Çertifikatës që dëshmon se i njëjti nuk është i dënuar për çështje penale me arsyetimin se ka mundur të ketë pasur pengesë teknike sistemi dhe të njëjtën Çertifikatë të datës 14.10.2023 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka bashkangjitur me rastin e parashtrimit të ankesës.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar përmbajtjen e konkursit të datës 18.09.2023 lidhur me kërkesat e përgjithshme për pranim dhe ka gjetur se ndër tjerash kërkesë për pranim ka qenë edhe: "Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji" dhe ka ardhur në përfundimin se ky kriter ka qenë

në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me prova materiale se më rastin e aplikimit të ketë ofruar dëshmi se i njëjti nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, përderisa në shkresat e lëndës nga dosjen e tij të aplikimit janë evidente faktet se i njëjti sipas Vërtetimit të datës 05.03.2020 ka qenë i punësuar në Zyrën e Punësimit në Deçan në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, prandaj me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit Divizioni i Burimeve Njerëzore të KKTK ka vepruar drejtë pasi që i njëjti është dashur të plotësojë kërkesat e përgjithshme për praninë sikurse ka qenë e caktuar me konkursin e shpallur të datës 18.09.2023, pa predikuar faktin nëse i njëjti ka pasur ose jo masë të shqiptuar disiplinore në cilësi të zyrtarit publik.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sjellë në vëmendje se pretendimi palës ankuesi se të njëjtit i është refuzuar aplikacioni për shkak se nuk ka bashkëngjitur Certifikatën për çështje penale janë të paqëndrueshme, ngase në Njoftimin e datës 26.10.2023 bëhet e qartë se ankuesit aplikacioni i është refuzuar mbi bazën e saj që i njëjti nuk ka përmbushur kërkesën e e përcaktuar në konkursin e datës 18.09.2023 lidhur me *"Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji"* kërkesë kjo e cila ka qenë në pajtueshmëri me kriteret e përgjithshme për praninë të përcaktuara me dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Prandaj, duke marrë për bazë dispozitat Rregullore Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku me nenin 12 paragrafi 2 përcaktohet se kandidatët me rastin e aplikimit duhet të bashkëngjisin kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion, ndërsa në nenin 15 paragrafi 3 përcaktohet se në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë, dhe mbi këtë bazë si dhe të konstatimeve të pasqyruara si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se Divizioni i Burimeve Njerëzore të KKTK-së me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit përmes Njoftimit të datës 26.10.2023 ka vepruar drejtë ngase ankuesi nuk ka plotësuar kërkesën e përcaktuar të konkursit të datës 18.09.2023 lidhur me çështjen *"Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji"*, kërkesë kjo e cila bazohet në dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill refuzohet si e bazuara sikurse në diapozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimit.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1419/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore,
- Arkivit të KPMShCK-së.

